



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal**

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 26 korrik 2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Doarsa Kica – Xhelili, Fidan Jilta, Valon Ramadani, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, Isak Shabani, Agim Veliu dhe Besnik Tahiri.

Munguan: Mërgim Lushtaku dhe Igor Simiq.

Në mbledhje morën pjesë: Feim Tahirsylaj, OSBE dhe GLPS.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Doarsa Kica -Xhelili, kryetare e komisionit, me këtë:

**Rend dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit plotësues të komisioneve të përhershme, për Projektligjin nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës;**
- 4. Votimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara**

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Raportit plotësues të komisioneve të përhershme, për Projektligjin nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës**

**Doarsa Kica –Xhelili**, konfirmoi se më 15.06.2022, komisioni ka shqyrtuar raportet e Komisioneve të përhershme për projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ka vendosur që Raporti i Komisionit FunkSIONAL të adresohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Pastaj, më 17 qershor 2022, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, ka adresuar raportin me rekomandimin si në vijim:

1. Projektligji nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç nenit 29, nënparagrafi 1.9.
2. I rekomandohet Komisionit FunkSIONAL që nënparagrafi 1.9 i nenit 29 të fshihet.

**Besnik Tahiri**, u deklarua se grupi parlamentar i AAK-së, të cilin ai e përfaqëson, nuk e përkrah amendamentin lidhur me të drejtën e votës të zv. ministrit në mbledhjet e Qeverisë, duke e konsideruar si antikushtetues, dhe po qe se i njëjti miratohet AAK do të paraqet ankesë në Gjykatën Kushtetuese.

**Besim Muzaqi**, propozoi që amendamenti të miratohet, të tjerët që kanë qëndrime ndryshe, kanë të drejtën e procedimit në Gjykatën Kushtetuese.

**Doarsa Kica –Xhelili**, tha se dispozita, për të cilën po diskutohet, është vlerësuar të inkorporohet në tekstin e P/ligjit për qëllim praktik, por çfarëdo që të vendos Gjykata Kushtetuese e mirëpresim.

**Agim Veliu**, tha se, nuk është e dobishme të votohet diçka që është kundërkushtetuese dhe për këtë arsye u deklarua se do të voton kundër.

**Konstatim:** Komisioni me gjashtë (6) vota” Për” dhe dy (2) “Kundër” miratoi Raportin me amendamente dhe i njëjti procedohet tutje për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

## **4. Votimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura**

**Doarsa Kica-Xhelili**, njoftoi komisionin se P/ligji, ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit, ndërsa propozoi votimin e raportit.

**Konstatim:** Komisioni me shtatë (7) vota” Për”, miratoi Raportin me amendamente dhe i njëjti procedohet tutje për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

## **5. Të ndryshme**

**Fitim Haziri**, njoftoi komisionin, se ka pranuar një email nga një anëtar i KPM-së, i cili kishte pyetur, se pse komisioni nuk po i përgjigjet kërkesës së KPM-së për një takim, lidhur me këtë ai pyeti kryetaren e komisionit se a ka pranuar email nga KPM me kërkesën për takim.

**Doarsa Kica-Xhelili**, u përgjigj, po, ka pasur një kërkesë për takim me kryetaren dhe jo për komisionin, por që takimi nuk është realizuar, me arsyen se nuk ka qenë, në atë fazë në interes të shkohet në KPM, për më tepër vlen të theksohet se takimi mund të realizohet me Komisionin në kohën kur në Kuvend do të procedohet plotësim - ndryshimi i Ligjit për KPM-në apo për çështje të tjera konform planit të punës së komisionit, por nëse komisioni vlerëson ndryshe takimi mund të realizohet javën e ardhshme.

**Fitim Haziri**, kërkoi nga kryetarja e komisionit, që për çdo kërkesë që e pranon nga palët e ndryshme e që ka të bëjë me fushëveprimin e komisionit, të njoftojë komisionin në mënyrë që deputetët në situata të tilla të mos dalin të painformuar.

**Doarsa Kica-Xhelili**, u deklarua se kërkesat që i pranon në emrin e kryetares së komisionit i trajton vet, ndërsa kërkesat për komisionin i adreson në komision.

**Valon Ramadani**, propozoi që të diskutohet edhe për çështjen e konfliktit të interesit për kryetarin e KPM-së, z. Xhevat Latifi, mbi bazën e email-it që kanë pranuar të gjithë anëtarët e komisionit nga një sinjalizues anonim dhe që çështja të diskutohet në komision dhe të kërkohet informacion nga AKK.

**Doarsa Kica- Xhelili**, propozoi, pa paragjykuar për konflikt interes, që për mbledhjen e radhës të hartohet shkresa për AKK-në dhe të prezantohet në komision, e më pastaj të adresohet në AKK për të kërkuar informatë se a ka konflikt interes kryetari i KPM-së.

**Besim Muzaqi**, propozoi që për çështjen e konfliktit të interesit për kryetarin e KPM-së, të diskutohet si pikë e veçantë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës dhe të gjitha kërkesat apo email-at që adresohen në adresën e kryetares të njoftohet komisioni, posaçërisht kërkoi reflektim të ngritjes së vullnetit për funksionimin më të mirë të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i Komisionit**

**Doarsa Kica- Xhelili,**

-----

**Kryetare e Komisionit**